




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina



KRYEQYTETI PRISHTINA
DREJTORIA PËR RINI DHE SPORT



Drejtoria për Rini dhe Sport e Komunës së Prishtinës, bazuar në Rregulloren Nr. 01-020/01-194101/18 të datës 08.08.2018 të Komunës së Prishtinës, si dhe në Rregulloren e Ministrisë së Financave Nr. 04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të organizatave joqeveritare, shpall:

THIRRJE PUBLIKE

Për ofrimin e mbështetjes financiare publike për projekt-propozime nga Klubet Sportive, Shoqatat dhe OJQ-të për organizimin e aktiviteteve sportive dhe rinore në Kryeqytet.

1. Drejtoria për Rini dhe Sport fton të gjitha klubet, shoqatat dhe OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës, të cilat ushtrojnë veprimtari në fushën e sportit dhe rinisë, të aplikojnë për mbështetje financiare për projektet që kontribuojnë në zhvillimin, masivizimin e sportit dhe përfshirjen rinore, duke u bazuar në politikat programore të kësaj drejtorie.

2. Fushat prioritare për financim përfshijnë:

- Masivizimin e sportit;
- Ngritjen e kapaciteteve në sport;
- Organizime sportive dhe promovimin e vullnetarizmit;
- Integrimin e grupeve rinore dhe atyre të marginalizuara;
- Fuqizimin e organizatave rinore përmes seminareve, trajnimeve dhe kurseve;
- Edukimin joformal për të rinjtë dhe të miturit.

3. Fondi total i planifikuar për këtë thirrje është 600,000.00 €.

Shuma minimale për një projekt: 500.00 €.

Shuma maksimale për një projekt: 12,000.00 €.

4. Afati për dorëzimin e propozimeve është nga 16.05.2025 deri më 30.05.2025.

5. Çdo aplikues mund të paraqesë vetëm një projekt.

Periodha e zbatimit të projektit është:

- Deri më 31.03.2026 për klubet sportive;
- Deri më 30.11.2025 për OJQ-të rinore dhe projektet sportive.

6. Aplikimi bëhet vetëm online përmes sistemit: <http://krs.prishtinaonline.com/>

7. Vlerësimi i projekteve dhe Komisioni përzgjedhës:

Vlerësimi i aplikacioneve bëhet nga Komisioni për Vlerësim të Projekteve, i caktuar nga Drejtoria për Rini dhe Sport në përputhje me dispozitat e Rregullores Komunale për Subvencione. Komisioni është i obliguar të respektojë parimet e transparencës, barazisë dhe profesionalizmit në shqyrtimin dhe vlerësimin e projekteve.

8. Kriteret për pjesëmarrje në thirrjen publike të subvencioneve për Sport dhe Rini:

- Klubet, Shoqatat dhe OJQ-të, të cilat veprojnë në Komunën e Prishtinës dhe realizojnë aktivitetin e tyre në Komunën e Prishtinës;
- Klubet, Shoqatat dhe OJQ-të, mund të subvencionohen vetëm një herë brenda vitit nga Komuna e Prishtinës;
- Klubet, Shoqatat dhe OJQ-të, të cilët nuk kanë përmbyllë raportin e subvencioneve të viteve paraprake nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Komunës së Prishtinës në këtë thirrje;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës;
- Klubet, Shoqatat dhe OJQ-të, nuk mund të përfitojnë me dy ose më shumë projekte nga subvencionet e Komunës së Prishtinës brenda një viti, qoftë edhe në kategori të ndryshme;
- Të drejtë aplikimi me projektet e tyre kanë klubet dhe OJQ-të që janë të regjistruara si OJQ në regjistrin e organizatave joqeveritare në Republikën e Kosovës, po ashtu klubet të cilat janë të regjistruara si klube sportive në Komunën e Prishtinës;
- Për të gjitha projektet që planifikohet të realizohen në shkollat e Komunës së Prishtinës apo me nxënësit e shkollave të Komunës së Prishtinës, paraprakisht duhet të merret pëlqim në Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA) për realizimin e projektit.

9. Dokumentacioni i nevojshëm:

Për OJQ-të Rinore:

- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së;
- Certifikata e nr. fiskal;
- Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-së;
- Vërtetimin që OJQ nuk ka obligime tatimore (nga ATK);
- Deklaratën për financim të dyfishtë.

Për Klube/Shoqata:

- Certifikata e regjistrimit të OJQ-së;
- Certifikata e nr. fiskal;
- Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
- Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës të përfaqësuesit të OJQ-së;
- Vërtetimin që OJQ/klubi/shoqata nuk ka obligime tatimore (nga ATK);
- Vendimin e regjistrimit të klubit/shoqatës;
- Deklaratën për financim të dyfishtë.

10. Vërejtje të rëndësishme:

- Aplikimet me dokumentacion të paplotësuar do të refuzohen automatikisht.
- Dokumentet e dorëzuara pas afatit nuk do të merren në shqyrtim.
- Ndryshimi i subjektit aplikues apo i xhirollogarisë pas dorëzimit nuk lejohet.
- Të dhënat në sistem duhet të jenë të përditësuara brenda afatit të aplikimit.
- Vetëm projektet që dorëzohen brenda afatit dhe që përmbushin plotësisht kriteret e thirrjes publike do të shqyrtohen për mbështetje financiare.

11. Komunikimi dhe informatat shtesë:

Për çdo pyetje apo sqarim, luteni të kontaktoni përmes email-it:

✉ sportrini.pr@rks-gov.net